

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE



## PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2012

### I DETYRUAR

### VARIANTI A

E shtunë, 2 qershor 2012

Ora 10.00

**Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe**

**Shkollat e mesme: artistike, koreografike, sportive, me kohë të shkurtuar (kurrikula e vjetër)**

**Udhëzime për nxënësin**

Testi në total ka **25 pyetje**, 13 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe 12 pyetje me zhvillim.

Testi është i ndarë në dy pjesë.

Në të tri pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

**Për përdorim nga komisioni i vlerësimit**

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8a	8b	9	10
Pikët											
Kërkesa	11a	11b	12	13	14	15	16	17	18	19	20a
Pikët											
Kërkesa	20b	21	22	23a	23b	24	25a	25b	25c	25d	
Pikët											

Totali i pikëve

**KOMISIONI I VLERËSIMIT**

1.....Anëtar

2.....Anëtar

**PJESA I****Dritëro Agolli****GRI**

Shumë ujë gri, shumë qiej gri,  
gri në dritare, gri në vetmi.  
Ikën lejlekët larg në arrati,  
Shumë ujë gri, shumë qiej gri.

Pikojnë strehët melankoli,  
Shumë strehë gri, shumë pika gri.  
Postier përtaci vjen në shtëpi  
Me pallto gri, me letra gri.

Hesht pas dritares maçoku i zi,  
Gazeta hapet me tituj gri.  
Gri në dritare, gri në vetmi,  
Ikën lejlekët larg në arrati...

*Për pyetjet nga 1 deri në 6 rrethoni alternativën e saktë.*

1. Kjo poezi i takon lirikës: **1 pikë**
  - A) shoqërore;
  - B) të peizazhit;
  - C) intime;
  - D) filozofike.
  
2. Cila është figura e stilistikës në vargun e mëposhtëm? **1 pikë**

*Pikojnë strehët melankoli*

  - A) Simboli;
  - B) Metafora;
  - C) Metonimia;
  - D) Paralelizmi figurativ.
  
3. Poezia është shkruar me varg: **1 pikë**
  - A) 7-rrokësh
  - B) 8-rrokësh
  - C) 9- rrokësh
  - D) 10- rrokësh
  
4. Fjala kyç e kësaj poezie është: **1 pikë**
  - A) gri;
  - B) uji;
  - C) qiejt;
  - D) lejlekët.
  
5. Në cilën nga vargjet e mëposhtme kemi përdorim të elipsës? **1 pikë**
  - A) Ikën lejlekët larg në arrati,
  - B) Postier përtaci vjen në shtëpi
  - C) Gri në dritare, gri në vetmi,
  - D) Gazeta hapet me tituj gri.

6. Në cilën prej alternativave kemi një rend të përmbysur sintaksor? **1 pikë**
- A) Postier përtaci vjen në shtëpi.  
 B) Hesht pas dritares maçoku i zi.  
 C) Gazeta hapet me tituj gri.  
 D) Me pallto gri, me letra gri.
7. Cili është motivi i kësaj poezie? **1 pikë**
- \_\_\_\_\_
- 8.
- a) Në nivelin e kujt mjeti stilistik ngrihet ngjyra *gri*? Ç'gjendje shpirtërore kërkon të zbulojë ajo? **2 pikë**
- mjeti stilistik: \_\_\_\_\_
- gjendja shpirtërore: \_\_\_\_\_
- b) Analizoni se ç'kërkon të theksojë përsëritja disa herë e kësaj fjale (*gri*) përgjatë të gjithë poezisë. **2 pikë**
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
9. Zbuloni figurën e intonacionit (të tingëllimit) të përdorur në këtë poezi. Tregoni funksionin që ajo kryen dhe ndjenjat që përcjell tek ju si lexues. **3 pikë**
- figura e intonacionit: \_\_\_\_\_
- funksioni: \_\_\_\_\_
- ndjenjat: \_\_\_\_\_
10. Cili është ritmi i kësaj poezie? Shpjegoni arsyen e këtij përdorimi. **2 pikë**
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- 11.
- a) Komentoni, përmes dy figurave të stilistikës, vargun e fundit të kësaj poezie, duke parë edhe raportin që ai krijon me të gjithë pjesën tjetër të poezisë. **3 pikë**
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- b) Në shumë nga vargjet mungon folja. Çfarë efekti do të krijojë poeti me anë të kësaj mungese? **1 pikë**
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
12. Identifikoni në poezi dy momente ku realiteti e përforcon gjendjen në të cilën ndodhet hero i lirik. **2 pikë**
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

**PJESA II****Balzak***Evgjeni Grande*

Pas vdekjes së nënës, Evgjenia u lidh edhe më ngushtë me vatrën ku kish lindur, ku kish vuajtur dhe ku kish dhënë shpirt e ëma. Kur sodiste dritaren, kolltukun e saj në sallë, sytë i mbusheshin me lot. Nisi të besonte se e kishte gjykuar keq të atin e saj plak, kur shikonte kujdesin e madh atëror që po tregonte ai. Kur zbriste për të ngrënë mëngjesin, ai e kapte përkrahu, ia mbërthente sytë ëmbël-ëmbël orë të tëra dhe e ruante sikur të ish prej floriri. Sa kish ndryshuar zoti Grande!

Por plaku e nxori sheshit fytyrën e tij të vërtetë gjatë darkës mortare, ku ndodhej dhe noteri Krysho, i vetmi që ia dinte sekretin vozaxhiut.

- Bija ime e dashur, - i tha Evgjenisë kur u ngrit sofrë dhe kur dyert u mbyllën me kujdes. – Tashti ti mbetesh e vetmja trashëgimtare e nënës sate dhe na mbeten hesape për të ndrequr midis nesh. Ashtu Krysho?
- A është ditë e përshtatshme që tamam sot të merremi me këtë punë, baba?
- Po, vajza ime. Mua s'më durohet dhe nuk besoj se do t'ia thyesh zemrën tyt eti.
- Oh, baba...
- Po, po! Kjo punë duhet të marrë fund që sonte.
- Po ç'kërkon nga mua, xhanëm?
- Atë e di ti e jo unë. Ja, fol më mirë ti, zoti Krysho.
- Zonjushë, yt atë nuk do as ta ndajë pasurinë e vet, as edhe të paguajë taksa tepër të mëdha për të hollat që ka në metal tingëllonjës. Pra, duhet mënjeluar inventari i të gjithë pasurisë, e cila ndodhet sot e pandarë midis teje dhe zotërisë, tyt eti...
- More, zotni Krysho, - e pyeti Evgjenia me padurim, - fundi i fundit ç'kërkoni prej meje?
- Ja, pra, - tha noteri, - duhet të nënshkruani një akt, me anën e të cilit hiqni dorë nga trashëgimi i zonjës, nënës suaj dhe ja lini atit shfrytëzimin e të gjithë pasurisë së pandarë midis jush, dhe për të cilin ai ju siguron zotërimin e zhveshur të pasurisë.
- Unë s'po marr vesh asgjë nga këto që më thonë, - u përgjigj Evgjenia, - po më jepni aktin dhe më tregoni vendin se ku duhet të vë firmën.
- Mojt bija ime, në vend që të nënshkruash këtë akt, që do të kushtojë një djall e gjysmë për t'u regjistruar, a nuk heq dorë krejt nga pasuria e të ndjerës nënës sate dhe të më lësh vetëm mua zotërues në të ardhmen? Kjo do të më pëlqente më shumë. Pastaj do të të jap për çdo muaj një të ardhur prej njëqind frangash. E more vesh, njëqind franga në muaj.
- Unë bëj ç'të duash ti, o im atë!
- Zonjushë, - i tha noteri, e ndiej për detyrë t'ju them se, po ta nënshkruani atë akt, mbeteni fare me gisht në gojë.
- Sa para bën për mua? – tha ajo.
- Të nesërmen, aty nga dreka, Evgjenia nënshkroi deklaratën, me anën e së cilës zhvishte vetveten. Me gjithë premtimin solemn, që i pat bërë së bijës, se do t'i jepte njëqind franga në muaj, vozaxhiu plak gjer në fund të vitit të parë, s'i kish dhënë asnjë dyshkë. Kur Evgjenia, një ditë ia zuri në gojë, si me shaka, ai s'mundi të mos skuqej nga turpi. U ngjit shpejt në kabinetin e vet, zbriti dhe i dha Evgjenisë një të tretën e stolive që i kish blerë Karlit.
- Ja, vogëlushe, - i tha së bijës me ironi, - i pranon këto njëmijë e dyqind frangat që të kam premtuar?
- Si? Vërtetë po m'i jep, me gjithë mend?
- Mot do të të jap edhe aq të tjera, ia ktheu plaku, duke ia hedhur në futë dhe shtoi: - në pak kohë do të t'i jap të gjitha çikërrimat e tij.
- Pastaj fërkoi duart i kënaqur që mundi të spekulonte edhe mbi ndjenjat e së bijës.

*Për pyetjet nga 13 deri në 19 rrethoni alternativën e saktë.*

- 13.** Kur Grandeja i kërkon Evgjenisë të merren me trashëgiminë, ajo i përgjigjet se është një ditë e papërshtashme. Pse ajo nuk dëshiron të merret pikërisht atë ditë me këtë çështje? **1 pikë**
- A) I trembet natyrës së Grandesë.  
 B) Nuk i interesojnë çështjet e pasurisë.  
 C) Ajo është dita që i takon nënës së saj.  
 D) I duhen disa ditë që të mendojë më qartë.
- 14.** Për Grandenë është një dramë e vërtetë: **1 pikë**
- A) humbja e bashkëshortes.  
 B) refuzimi i Evgjenisë për të falur pasurinë.  
 C) frika se mos Kryshoja i tregon Evgjenisë të vërtetën.  
 D) kërkesa e Evgjenisë për më shumë se njëqind franga.
- 15.** Kur autori rrëfen: “*Pastaj fërkoj duart i kënaqur që munda të spekulonte edhe mbi ndjenjat e së bijës*”, do të thotë që plaku Grande ishte i kënaqur që munda: **1 pikë**
- A) ta bënte Evgjeninë si veten.  
 B) ta vinte në provë të bijën.  
 C) të luante me ndjenjat e së bijës.  
 D) ta vinte në pozitë të vështirë të bijën.
- 16.** Cila nga alternativat e mëposhtme është shembull i ironisë? **1 pikë**
- A) Po, po! Kjo punë duhet të marrë fund që sonte.  
 B) E more vesh, njëqind franga në muaj.  
 C) Unë bëj ç’ të duash ti, o im atë!  
 D) Sa kish ndryshuar zoti Grande!
- 17.** Cilat cilësi i atribuon Balzaku Evgjenisë në këtë fragment? **1 pikë**
- A) E zgjuar dhe e hedhur.  
 B) Modeste dhe e ndrojtur.  
 C) E bukur dhe elegante.  
 D) Dinake dhe tekanjoze.
- 18.** Në këtë fragment noteri përpiqet: **1 pikë**
- A) ta paralajmërojë Evgjeninë për pasojat e veprimit të saj.  
 B) të mbrojë interesat e plakut Grande nga humbja e papritur.  
 C) të përfitojë nga situata e krijuar midis të atit dhe të bijës.  
 D) të mbrojë pozicionin e tij si noter profesionist.
- 19.** Në fjalinë: “Në pak kohë do të t’i jap të gjitha çikërrimat e tij”, fjala *çikërrimat* ka kuptimin: **1 pikë**
- A) florinjte;  
 B) sendet;  
 C) paratë;  
 D) vogëlsirat.

20.

- a) Në fillim të këtij fragmenti Evgjenia beson se i ati ka ndryshuar. Pse ajo mendon kështu? Identifikoni një moment në fragment që ilustron pikërisht këtë. **2 pikë**

---



---

- b) Cila është arsyeja e vërtetë që Grandeja sillet në këtë mënyrë me Evgjeninë? **1 pikë**

---

21. Analizoni thelbin e marrëdhënies midis plakut Grande dhe të bijës. **2 pikë**

---



---

22. Zbuloni në këtë pjesë një shprehje frazeologjike dhe zëvendësojeni me një sinonim. **2 pikë**

shprehja frazeologjike: \_\_\_\_\_

sinonimi: \_\_\_\_\_

23.

- a) Cili është raporti që Evgjenia ka me paranë? Mendimin tuaj mbështeteni me një shembull nga fragmenti. **2 pikë**

---



---

- b) Nisur nga konteksti, me ç'ton i thotë Grandeja fjalët e mëposhtme? Çfarë na lë të kuptojmë ai (*toni*) në lidhje me natyrën e plakut? **2 pikë**

*Po, po! Kjo punë duhet të marrë fund që sonte.*

---



---

24. Cila është ndjesia që keni për secilin nga të dy personazhet qendrore të kësaj pjese? **2 pikë**

---



---



